



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 21.12.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail datë 14.12.2022.

Z. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 14.12.2022 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1- Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë që përcakton tarifatat vendore të plazheve (që është marrë për bazë në kuadër të këtij investimi);

Sipas vendimit nr 544 datë 27.7.2016, i ndryshuar me VKM nr.394 datë 3.5.2017 subjekti GREEN COAST tarifohet si çdo subjekt tjetër në Bashkinë Himarë.

Bashkëngjitur do të gjeni link-un për paktën fiskale të vitit 2022.

<https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-himare-nr-54-date-25-11-2021/>

2-Kontrata ose kontratat e lidhur/a midis Bashkisë Himarë dhe shoqërisë “GREEN COAST” SHPK, për përdorimin e brigjeve sipas sipërfaqjes objekt përdorimi, bazuar në V.K.M.-në nr. 544, datë 27.07.2016“Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “GREENCOAST””, të ndryshuar.

Bashkëngjitur kontrata



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA HIMARË

Nr. 31 Prot.

Himarë, më 11.05.2018

KONTRATË
PËR PËRDORMIN E PLAZHIT DHRALEO,
HIMARË

Sot më datë 11.05.2018 (dy majë e tetëmbëdhjetë), në Himarë, nënshkruhet kjo kontratë për përdorim plazhi ("Kontrata") nga dhe ndërmjet palëve, si më poshtë:

Bashkia Himare, përfaqësuar nga z. Jorgo Guro, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë ("Autoriteti Publik")

Dhe


GREEN COAST Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në "Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Katë 4, Apartamenti nr.

31, Tiranë", e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: 14152 9038D, përfaqësuar nga administratori Znj. Evis Çeliku, shënime shoqëtare, lindur në Tiranë, në datën 23.09.1975, mbajtëse e lehtënjohimit me nr. 053320220 dhe me numër personal 11559231231, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar ("Përdoruesi").

Këtu më poshtë së bashku referuar si "Palët" dhe veç e veç si

"Pala", MEQENËSE:

- A) Përdoruesi, në përputhje me ligjin nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike" dhe nënshkruar në Vendimin nr. 2/13, datë 14.07.2016 të Komitetit të Investimeve Strategjike, ka përfunduar statusin e investitorit strategjik, procedurë e asistuar, për realizimin e Projektit "Green Coast", në Palasë, Himarë, zona kadastrale 1481-1739. Në bazë të sa me sipër, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 27.07.2016 "Për lejin e përdorimit të brigjeve në funksion të Projektit Investim Strategjik "Green Coast", në Palasë, Himarë", të ndryshuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 03.05.2017, ka fituar të drejtën për të shfrytëzuar hapësirën e plazhit në zonën ku do të ndërtohet Projekti.
- B) Gjithashtu Përdoruesi në cilësinë e investitorit strategjike është pajisur nga Këshilli Kombëtar i Territorit me lejen e zhvillimit sipas Vendimit nr. 6 date 22.02.2017 "Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për shëtitoren buze deti : "Langomare", në plazhin e Dhraleos, Bashkia Himare, me subjekt zhvillues shoqërië "Green Coast" sh.p.k.", në bazë të së cilës përcaktohen objektet ndërtimore konkrete me qëllim rekreativ që do të miratohen te



Ju falenderojmë për mirëkuptimin!